

**Interview To  
Zamir Dedej  
Ministria E Mjedisit**

**P: Cili eshte roli i Ministrise se Mjedisit ne projektin TWReferenceNET?**

**P:** Roli kryesor i Ministrise se Mjedisit, eshte qe te koordinoje veprimtarite qe zbatohen ne fushen e mjedisit dhe per te cilat kerkohet ndihme dhe prania e saj. Edhe ne Projektin TWReferenceNet Ministria e Mjedisit ne bashkepunim me Fakultetin e Shkencave te Natyres ne Universitetin e Tiranës dhe Institucioneve kerkimore-shkencore (Instituti i Kerkimeve Biologjike) te Akademise se Shkencave koordinon veprimtarine ne kuader te projektit. Prania dhe mbeshtetja e stafit te Ministrise ndaj ketij projekti eshte nje avantazh persa i perket angazhimit te organeve shteterore ne realizimin e detyrave dhe objektivave te projektit si dhe eshte nje garanci me shume ne arritjen e rezultateve te pritshme te projektit, duke pasur parasysh edhe veshtiresite administrative qe paraqet programi Interreg ne pergjithesi dhe ai Cadses ne vecanti.